



QENDRA KOMBËTARE
E BIZNESIT
Nr. 6710 Prot,
Data 07.03.2022

SEKRETARIA
03 MAR 2022
Nr. 1445 Regj Nr. 646 Prot

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT "AEF" SH.P.K

URDHËR

"për heqjen e sekuestros konservative"

Drejtuar : Qendra Kombëtare e Biznesit
Për dijeni : Shoqëria "Atrium" shpk (ish Shoqëria "Bridge Plus" sh.p.k) me NIPT L81828011Q
Për dijeni : Shoqëria F&M Reklama sh.p.k me NIPT L31716006E

Pranë Zyrës së Përmbartimit Gjyqësor Privat të Shoqërisë "AEF BAILIFF SERVICE" sh.p.k. me kërkesë të palës kreditore është rregjistruar çështja përmbartimore me palë :

Debitor : Shoqëria "Bridge Plus" sh.p.k(sot Shoqëria "Atrium" shpk) me NIPT L81528011Q
Kreditorit : Shoqëria F&M Reklama sh.p.k me NIPT L31716006E
Objekti : Likujdim detyrimi

Unë Përmbartuesi Gjyqësor Emiljano GJOZA pasi shqyrtova materialin e dosjes përmbartimore,

KONSTATOVA:

Për titullin ekzekutiv Fatura Tatimore Nr. Serie 63460035 datë 09.08.2018 është lëshuar Urdhri i Ekzekutimit Nr. 9273 datë 14.11.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt:
"Lëshimin e urdhrimit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv Fatura Tatimore Nr. Serie 63460035 datë 09.08.2018".
Pasi kanë kaluar afatet e parashikuara ligjore dhe debitori nuk e ka përmbushur detyrimin, në bazë të nenit 519 të K.Pr.Civile nga ana e jonë është marrë vendimi i kalimit në ekzekutim të detyrueshëm duke vendosur masën e sekuestros konservative për debitorin Shoqëria "Atrium" shpk (ish Shoqëria "Bridge Plus" sh.p.k) me NIPT L81828011Q me qëllim mos kryerjen e asnjë veprimi i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrimit tregtar.
Pas kryerjes së këtyre veprimeve procedurale , vendosjes së sekuestros konservative, pala debitore Shoqëria "Atrium" shpk me NIPT L81828011Q ka përmbushur tërësisht detyrimin dhe duhet të vendoset pushimi i urdhrimit të ekzekutimit bazuar në nenin 616 /a të K.Pr.Civile .

Për këtë arsye si dhe në bazë të nenit 616/a të K.Pr.Civile,

URDHËROJ:

1. Heqjen e masës së sekuestros konservative për debitorin Shoqëria "Atrium" shpk (ish Shoqëria "Bridge Plus" sh.p.k) me NIPT L81828011Q, e vendosur me shkresën tonë nr.1445 regj , nr.635 prot, datë 01.03.2022.
2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj,duhet të na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
3. Ky urdhër mbahet ne 4 kopje e ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brënda 5 ditëve nga marja dijeni.

Zyra e Përmbartimit Privat AEF shpk
Përmbartuesi Gjyqësor
Emiljano A Gjoza

